

Bazuar në nenin 6 të Ligjit për trajnim dhe provim për drejtor në shkollë fillore, shkollë të mesme, konviktin e nxënësve dhe universitet të hapur qytetar për mësim gjatë gjithë jetës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/15, 145/15, 192/15, 30/16, 120/18 dhe 140/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" së Veriut" nr. 235/24), neni 13 paragrafi (1) i Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 29/25) dhe neni 5 paragrafi 1 i Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve, nr. 01-440/3, datë 28.12.2022, nr. 01-176/3 datë 1.3.2023, nr. 01-197/3 datë 15.04.2024, nr. 01-109/3 datë 11.02.2025 dhe nr. 01-157/4 datë 25.3.2025, Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall

KONKURS PUBLIK I PËRSËRITUR *për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm trajnues*

I. Qendra Shtetërore e Provimeve shpall Konkurs për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – trajnues për realizimin e Programit për trajnimin dhe provimin e drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme për modulet në vijim:

1. **Moduli numër 1 – Aplikimi i teknologjisë informatike-kompjuterike gjatë menaxhimit në arsim –** një trajnues në gjuhën mësimore shqipe;
2. **Moduli numër 2 – Teoria e organizimit** - një trajnues në gjuhën mësimore shqipe;
3. **Moduli numër 3 – Njerëzit në organizim** - një trajnues në gjuhën mësimore shqipe;
4. **Moduli numër 4 – Drejtori si udhëheqës pedagogjik** - një trajnues në gjuhën mësimore shqipe;
5. **Moduli numër 6 – Legjislacioni** - një trajnues në gjuhën mësimore shqipe.

II. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

Kushte të përgjithshme:

- të kenë të kryer të paktën arsimin sipëror — të nivelit VII A të kornizës nacionale të kualifikimeve;
- të kenë të paktën 5 (vjet) përvojë pune në institucion edukativo-arsimor ose të veprimtarisë shkencore dhe
- të kenë përvojë si trajnues nga fusha e përmbajtjes së modulit për të cilin konkurron.

Kushte të posaçme:

- të kenë të kryer të paktën studime akademike të ciklit të dytë nga fusha përkatëse;
- të kenë të publikuara punime profesionale, përkatësisht punime shkencore nga fusha e përmbajtjes së modulit për të cilin konkurron dhe
- të kenë të përgatitur Planin për realizimin e përmbajtjeve të modulit për të cilin konkurrojnë, i cili duhet të përmbajë qëllimet, metodologjitë dhe burimet e nevojshme për secilin veçmas.

III. Kandidatët detyrimisht dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

- fletëparaqitje të plotësuar (formulari i aplikimit është i vendosur në ueb-faqen www.dic.edu.mk);
- një kopje të certifikatës/diplomës së studimeve akademike të kryera të ciklit të dytë nga fusha përkatëse, të noterizuar;
- vërtetimin të përvojës së punës në institucionin edukativo-arsimor ose në veprimtarinë shkencore në origjinal ose në kopje të noterizuar;
- provë për realizimin e trajnimeve si trajnues nga fusha e përmbajtjes së modulit për të cilin po konkurrohet;

- një kopje të ballinës së punimeve të publikuara profesionale, përkatësisht punimeve shkencore nga fusha e përmbajtjes së modulit për të cilin konkurrohet;
- Planin për realizimin e përmbajtjeve të modulit për të cilin konkurrojnë, i cili duhet të përmbajë qëllimet, përmbajtjet, kohëzgjatjen, metodologjitë dhe resurset e nevojshme për çdo temë veçmas.

IV. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm – trajnues bëhet në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuar me Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm të qendrës Shtetërore të Provimeve

V. Kandidatët të cilët do të përzgjidhen për bashkëpunëtorë të jashtëm - trajnues do të angazhohen për periudhë prej 2 (dy) vjetësh, llogaritur nga dita e lidhjes së kontratës së angazhimit.

VI. Afati për aplikim të kandidatëve të interesuar është përfundimisht me 2.5.2025.

VII. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të bëhet më së voni në afat prej 18 (tetëmbëdhjetë) ditësh pas skadimit të afatit për aplikim.

VIII. Dokumentacioni i dërguar me vonesë, jovalid dhe i pakompletuar, nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.

IX. Fletëparaqitjen me dokumentacionin e duhur dorëzohet në Arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve (nga ora 10:00 deri në ora 14:00) ose përmes dërgesës së rekomanduar postare, në adresën në vijim: *Qendra Shtetërore e Provimeve – Shkup rr. "Vasil Gjorgov" p.n. 1000 Shkup*, me shënimin **"Për konkursin publik për bashkëpunëtorë të jashtëm – trajnues"**.

X. Informacione plotësuese për konkursin mund të merren në telefonin me numër 075/300-606, çdo ditë pune, nga ora 10,00 deri në ora 14,00.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE SHKUP